

## **MANUAL UDHËZUES**

### **“MBI PROCESIN E INFORMACIONIT TË DETYRUESHËM TARIFOR”**

Shënim: Ky manual është një dokument i natyrës udhëzuese që u vjen në ndihmë strukturave doganore dhe operatoreve ekonomik. Manuali jep sqarime të dispozitave përkatëse të legjislacionit, me qëllim që ato të zbatohen në mënyrë uniforme. Dispozitat ligjore kanë përparësi mbi përmbajtjen e këtij dokumenti dhe duhet të konsultohen gjithmonë.

## Përmbajtje

1. Objektivi i këtij manuali
2. Hyrja
3. Faza para aplikimit
4. Aplikimi për IDT.
5. Konsultimi me bazën e të dhënave IDT
6. Lëshimi i një IDT
7. Vendime jo uniforme IDT
8. Natyra ligjore e një IDT
9. E drejta për t'u dëgjuar
10. Anulimi i Vendimeve IDT (ex tunc)
11. Vendime IDT që nuk janë më të vlefshme apo revokohen (ex nunc)
12. Periudha e përdorimit të zgjatur (Period of grace)
13. Listë Kontrolli
14. Zbatimi i Manualit
15. Aneksi 1 Ndryshimet kryesore në procesin IDT që rrjedhin nga KD
16. Aneksi 2 aplikimi për Informacionit të Detyrueshëm Tarifor
17. Aneksi 3 Vendim i Informacionit të Detyrueshëm Tarifor

### Fjalor i termave dhe shkurtimeve që lidhen me IDT<sup>-në</sup>

Informacion i Detyrueshëm Tarifor ( IDT)	Informacioni i detyrueshëm tarifor është një vendim i lëshuar nga administrata doganore që është detyrues për të gjithë administratën doganore dhe për mbajtësin e vendimit.
NK	Nomenklatura e Kombinuar ose NK është nomenklatura e klasifikimit të mallrave doganore të RSH. Ajo bazohet në Sistemin e Harmonizuar. Të gjitha mallrat e importuara ose të eksportuara duhet të klasifikohen në përputhje me NK <sup>-në</sup> . Numrat e kodit NK kanë 8 shifra.
Emërtimi Tregtar	Emërtimi tregtar nënkupton emrin me të cilin mallrat janë të njohura në terma tregtarë, pra emrin tregtar. Emërtimi tregtar në vendimet e IDT-së është informacion konfidencial.
RSH	Republika e Shqipërisë
Tarifa Doganore e RSH	TD është tarifa doganore e përdorur në Republikën e Shqipërisë.
Bashkimi Doganor	Bashkimi Doganor formohet kur një grup vendesh krijojnë një zonë të tregtisë së lirë midis tyre dhe aplikojnë një tarifë të përbashkët në tregtinë e jashtme.
Shënime Shpjeguese	Si HS ashtu edhe NK plotësohen me Shënimet Shpjeguese, të cilat megjithëse nuk janë ligjërisht të detyrueshme konsiderohen si ndihmë për klasifikimin e mallrave në secilën prej nomenklaturave.

HS	HS është shkurtim i përdorur për Sistemin e Harmonizuar të Përshkrimit dhe Kodimit të Mallrave (i njohur edhe si Sistemi i Harmonizuar). NK është bazuar në nomenklaturën HS. Vendimet e IDT nuk lëshohen me Kodet e HS.
TARISH	TARISH, Tarifa e Integruar e RSH, është një bazë të dhënash në të cilën janë integruar të gjitha masat që lidhen me tarifën doganore të RSH-së, legjislacionin tregtar dhe atë bujqësor. Numrat e kodit TARISH janë me 10 shifra.
Klasifikimi i Tarifës	Të gjitha mallrat e importuara ose të eksportuara duhet të klasifikohen në Nomenklaturën e Kombinuar. Klasifikimi tarifor do të përcaktojë tarifën doganore dhe çdo tarifë tjetër doganore (p.sh. tarifën antidumping) që kanë mallrat. Neni 56 i KD thekson se detyrimet e importit dhe eksportit do të bazohen në tarifën doganore të RSH.
Numri i Kodit Tarifor	Të gjitha mallrat e importuara ose të eksportuara nga RSH duhet të kenë një kod tarifor. Trajtimi doganor i mallrave përcaktohet nga kodi tarifor dhe tregtari mund të vlerësojë çdo detyrim ose ngarkesë tjetër që mallrat kanë. Kodet tarifore u caktohen mallrave në bazë të karakteristikave të tyre objektive dhe janë të përcaktuara në NKM e RSH.
KD	Kodi Doganor i RSH, (Ligji nr.102 /2014 datë 31 korrik 2014. Hyrë në fuqi më 1 qershor 2017.
DZ	Dispozitat Zbatuese (VKM nr.651/2017, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i RSH”).

## 1. OBJEKTIVAT E MANUALIT UDHËZUES

Manuali udhëzues Mbi Procesin e Informacionit të Detyrueshëm Tarifor, ka për qëllim të:

- Ofrojë një pasqyrë të përgjithshme autoriteteve doganore dhe operatorëve ekonomik mbi procesin e Informacionit të Detyrueshëm Tarifor (IDT);

## **2. HYRJA**

Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave (d.m.th. Nomenklaturën e Kombinuar ose TARISH, sipas rastit), e cila është pjesë e Tarifave Doganore të RSH, përdoret dhe për qëllime të tjera përveç marrjes së detyrimeve doganore, siç janë: mbledhja e statistikave të tregtisë së jashtme, identifikimi i produkteve që i nënshtrohen kufizimeve të importit dhe eksportit, përcaktimi i produkteve që i nënshtrohen akcizës ose niveleve të reduktuara të tatimit mbi vlerën e shtuar si dhe përcaktimi i rregullave të origjinës, etj.

Informacionin i Detyrueshëm Tarifor (IDT) ka për qëllim garantimin e sigurisë juridike për operatorët ekonomik për llogaritjen e çmimit të transaksioneve të importit ose eksportit dhe lehtësimin e punës së shërbimeve doganore si dhe sigurimin e një aplikimi të njëjtë të Tarifës Doganore.

Të gjitha vendimet e vlefshme IDT publikohen në faqen e internetit ([www.dogana.gov.al](http://www.dogana.gov.al)) të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Qëllimi i këtij udhëzimi është të ndihmojë autoritet doganore dhe operatorët ekonomikë të njihen me procedurat në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Procedurat dhe fazat që lidhen me lëshimin e vendimeve IDT mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Faza para-aplikimit;
- Aplikim për IDT;
- Konsultimi i bazës së të dhënave IDT;
- Rastet me opinione të ndryshme klasifikimi;
- Lëshimi i një IDT ;
- Rastet me IDT jo uniforme;
- Anulimi i një IDT;
- Kur vendimet IDT pushojnë të jenë të vlefshme ose të revokohen; dhe
- Procedurat e Apelimit, përfshirë rolin e gjykatave.

## **3. FAZA PARA APLIKIMIT**

Neni 22 të KD i detyron autoritetet doganore të japin informacion mbi zbatimin e legjislacionit doganor, përfshirë klasifikimin e mallrave. Bazuar në pikën 2, të nenit 36 të KD, lidhur me IDT, kjo është e detyrueshme vetëm nëse lëshohet brenda kornizës së ITD dhe natyra detyruese e vendimeve të vlefshme IDT është e tillë qoftë për autoritetet doganore ashtu edhe për mbajtësin e këtij vendimi.

Klasifikimi tarifor i mallrave, që të njihet ligjërisht, duhet të merret nëpërmjet një vendimi IDT.

Në zbatim të pikës 1, nenit 53 të KD, autoritetet doganore nuk vendosin pagesa për kryerjen e procedurave doganore ose për çdo zbatim tjetër të legjislacionit doganor gjatë orarit zyrtar të punës.

Nga Autoritetet Doganore nuk aplikohet pagesë për lëshimin e një vendimi IDT. Megjithatë, në zbatim me pikën 2 të Nenit 53 të KD, autoritetet doganore mund të vendosin pagesë për shpenzimet që lidhen me analizat ose raportet e ekspertëve për mallrat dhe tarifatat postare për kthimin e mallrave tek aplikuesi.

Autoritetet doganore mund të pranojnë çdo dokument dhe informacion që shoqëron ose mbështet kërkesën në gjuhën shqipe, ose kërkon përkthimin e pjesshëm ose të plotë të këtyre dokumenteve ose të këtij informacioni në shqip, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

#### **4. APLIKIMI PËR IDT**

Aplikimi për IDT duhet të paraqitet sipas formularit të Aplikimit për Informacionin e Detyrueshëm Tarifor, në Aneksin 2 të Shtojcës C të DZ. Formulari i aplikimit duhet të plotësohet në mënyrë korrekte në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe "Informacionin e përgjithshëm mbi plotësimin e kërkesës për informacion të detyrueshëm tarifor", e cila gjendet në faqen e internetit [ëëë.dogana.gov.al](http://ëëë.dogana.gov.al).

Për një IDT nuk mund të aplikojnë një grup operatorësh, as një operator nuk mund të aplikojnë për disa lloje të ndryshme mallrash.

Aplikantët duhet të vendosin numrin e Niptit (NUIS) në aplikimet e tyre.

Aplikimet IDT duhet të lidhen me një produkt. Mallrat të cilat kanë karakteristika të ngjashme mund të pranohen si një produkt, me kusht që dallimet të jenë të parëndësishme për qëllimet e përcaktimit të klasifikimit të tyre tarifor, p.sh. vazot e luleve prej materiali të njëjtte, me dimensione të ndryshme.

Duhet të theksohet se është përgjegjësi e aplikuesit të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për të klasifikuar mallrat.

Formulari i aplikimit për IDT përmban 13 kuti (të detyrueshme dhe fakultative) që duhet të plotësohen nga aplikuesi, i cili duhet jap ose të tregoj (sipas rastit) informacionet e mëposhtme :

- nomenklaturën doganore në të cilën duhet të lëshohet vendimi (kutia 5);
- përshkrimi i hollësishëm i mallrave, përfshirë përshkrimin e tyre fizik, funksionin, përbërjen, karakteristikat dhe procesin e prodhimit, kur është e përshtatshme (kutia 8);

- informacione shitesë, p.sh. Mostrat, fotografitë, planet, katalogët, etj., të cilat mund të ndihmojnë autoritetet doganore të përcaktojnë klasifikimin (kutia 10);
- klasifikimi tarifor i parashikuar nga aplikuesi (kutia 7);
- të dhënat që duhet të trajtohen si konfidenciale (kutia 9);
- nëse aplikuesi ka aplikuar ose ka një vendim të vlefshëm IDT (kutia 11);
- pranimi i tij/ saj se informacioni i dhënë është ruajtur në bazën e të dhënave IDT dhe se informacioni jo-konfidencial i ofrohet publikut nëpërmjet internetit.

Përsa i përket kutive të ndryshme në aplikimin IDT, administratat doganore duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçante pikave të mëposhtme:

***“Aplikuesi”(Kutia 1) / “Mbajtësi” (Kutia 2):***

Aplikuesi për një vendim IDT do të bëhet automatikisht mbajtës i atij vendimi. Të gjithë aplikuesit duhet të kenë një numër NUIS dhe ta vendosin në aplikimet e tyre.

***“Përfaqësuesi”(Kutia 3):***

Çdo operator ka të drejtë të caktojë një palë tjetër për ta përfaqësuar atë në marrëdhëniet e tij me autoritetet doganore. Megjithatë, ekzistojnë disa kritere dhe detyrime që personat që përmbushin këtë rol duhet t'i plotësojnë (Neni pika 1, neni 24 i KD).

Përfaqësuesit doganor duhet të jenë të vendosur brenda territorit të RSH në përputhje me përcaktimet e pikës 2 dhe 3 të Neni 24 të Kodit.

Përfaqësimi mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë. Përfaqësimi i drejtpërdrejtë nënkupton që përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të një personi tjetër, përkatësisht kërkuesit/mbajtësit. Përfaqësimi i tërthortë do të thotë se përfaqësuesi doganor vepron në emër të tij/saj, por për llogari të një personi tjetër, përkatësisht kërkuesit/mbajtësit (pika 1, neni 24 i KD).

Personi i cili nuk deklaron se ai ose ajo vepron si përfaqësues doganor ose që deklaron se ai ose ajo vepron si përfaqësues doganor, por nuk është i autorizuar ta bëjë këtë, do të konsiderohet se vepron në emrin e tij/saj dhe për llogari të tij/saj (pika 1, neni 25 i KD).

Në rastet kur përdoret shërbimi i një përfaqësuesi, autoritetet doganore kanë të drejtë të kërkojnë prokurën përkatëse të përfaqësimit.

***“Përshkrimi i mallrave” (Kutia 8):***

Përshkrimi i mallrave duhet të mundësojë identifikimin e saktë të sendit që klasifikohet pasi është lidhja midis IDT dhe mallrave të deklaruar. Vendosja e përshkrimit të nomenklaturës lejohet vetëm në raste se ky përshkrim i korrespondon plotësisht përshkrimit të produktit, përfshirë dhe të gjitha informacionet e nevojshme për klasifikimin e produktit.

Me qëllim që të ndihmohen autoritetet doganore në identifikimin e mallrave, aplikuesi përveç përcaktimit se cilat janë këto mallra, duhet gjithashtu të japë informacion për përshkrimin fizik të tyre, funksionin ose përdorimin, përbërjen e mallrave si dhe përshkrimin e karakteristikave të tyre, si p.sh. madhësia, ngjyra, paketimi ose karakteristika të tjera, procesi i prodhimit të tyre,

Nëse ndonjë prej këtyre elementeve përshkruhet në mënyrë të pamjaftueshme ose mungon, atëherë autoriteti doganor, për të përcaktuar klasifikimin e mallrave kërkon informacion shtesë. Ky informacion që mungon duhet të paraqitet nga aplikuesi brenda një afati të arsyeshëm kohor që nuk i kalon 30 ditë, sipas pikës 2, të nenit 29 të DZ. Nëse aplikuesi nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati, aplikimi nuk do të pranohet dhe aplikuesi duhet të njoftohet, sipas pikës 3, të nenit 29 të DZ.

Kjo kuti nuk duhet të përmbajë informacione konfidenciale. Informacione si p.sh. Emrat tregtar, numri i artikullit etj. duhet të përfshihen vetëm në kutinë 9 nën "emërtimi tregtar".

***“Aplikime të tjera IDT dhe IDT të tjera të mbajtura” (Kutia 11):***

Aplikuesi duhet të deklarojë nëse ka aplikuar ose zotëron ndonjë vendim të vlefshëm IDT të lëshuar për produktet identike ose të ngjashme.

Kutia 11 ka të bëjë vetëm me aplikimet ose IDT-të e mbajtura nga aplikuesi që aplikon për/apo mbajtësin e ardhshëm të vendimit IDT.

Afati kohor për lëshimin e vendimeve IDT parashikohet në legjislacionin doganor. Nëse administrata doganore nuk disponon të gjithë elementet e nevojshme për të mundur përcaktimin e klasifikimit tarifor, ajo duhet të informojë aplikuesin pa vonesë, brenda 30 ditëve nga data e pranimit të kërkesës së tij, me qëllim informimin për plotësim informacioni Data e plotësimit të kërkesës zyrtarisht është dhe data nga e cila fillon periudha e lëshimit të vendimit. (Pika 2, e Neni 27 të KD).

Vendimi IDT duhet të lëshohet jo më vonë se 120 ditë nga data e pranimit të kërkesës. Nëse autoritetet doganore nuk janë në gjendje të lëshojnë vendimin brenda afatit të përcaktuar, ata duhet të njoftojnë kërkuuesin para skadimit të 120 ditëve nga data e fillimit të afatit të lëshimit. Njoftimi duhet të shpjegojë arsyet e vonesës dhe të informojë aplikuesin për periudhën shtesë të kohës që dogana e konsideron të nevojshme për lëshimin e vendimit IDT. Ky afat kohor nuk duhet të kalojë 30 ditë, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe. (Pika 3, Neni 27 të KD).

Kur paraqitet aplikimi, rekomandohet që të shoqërohet dhe me imazhe të mallrave me qëllim zvogëlimin e rrezikut të lëshimit të IDT-ve të ndryshme. Imazhet e bashkëngjitura në aplikim jo domosdoshmërisht i bashkëngjiten vendimeve të IDT-ve, megjithatë rekomandohet që të pasqyrohen, përveç rasteve kur ka arsye për të mos i bashkëngjitur.



Kur paraqitet një kërkesë për një vendim IDT, kërkuesi ka detyrimin/përgjegjësinë për sigurimin e të gjithë informacionit të kërkuar nga autoritetet doganore për marrjen e vendimit. (KD Neni 27 (1))

Në rastin e vendimeve IDT, autoritetet doganore mund të kërkojnë detaje shitesë ose një mostër të mallrave të cilave u referohet kërkesa. Megjithatë, duhet të mbahet parasysh se aplikuesi mund të mos jetë në zotërim të informacionit të kërkuar dhe mund t'i duhet ta marrë atë nga një burim tjetër. Në këto kushte aplikuesi mund të kërkojë kohë për të siguruar informacionin e nevojshëm ose një mostër.

Informacione të caktuara mund të jenë të disponueshme vetëm si rezultat i një analize të kryer nga një laborator. Aplikuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se nuk ka asnjë detyrim ndaj autoriteteve doganore për të ndërmarrë një analizë laboratorike në emër të tij / saj, por autoritetet doganore mund të vendosin të bëjnë analiza laboratorike, veçanërisht në rastet kur klasifikimi varet nga përbërja e mallrave.

Në këto raste, aplikuesi duhet të njoftohet se kërkohet një analizë dhe se laboratorit doganor është i gatshëm ta kryejë atë në emër të tij/ saj. Termat dhe kushtet që lidhen me kryerjen e një analize të tillë, duhet të tregohen qartë në njoftim, duke përfshirë çdo pagesë që kërkuesi duhet të paguajë në lidhje me këtë analizë. (pika 2, e Nenit 53 të KD)

## **5. KONSULTIMI ME BAZËN E TË DHËNAVE IDT**

Neni 39 i DZ reflekton detyrimin e administratës doganore për të konsultuar bazën e të dhënave të IDT dhe për të mbajtur një regjistër të këtyre konsultimeve.

Konsultimet në bazën e të dhënave IDT mund të kryhen duke përdorur një numër kriteresh kërkimi. Ndër këto kriteret janë: numri NUIS (NIPTI), emri i aplikuesit, emri i mbajtësit, përshkrimi i mallrave, emërtimi tregtar, numri i kodit tarifor të parashikuar nga aplikuesi, numrat e kodeve alternative të mundshme dhe periudha e vlefshmërisë. Përveç kësaj, imazhet dhe fjalë kyçe luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në kërkimet e tilla në bazën e të dhënave dhe administrata doganore duhet të garantojë publikimet e Vendimeve të IDT-së dhe aty kur është e mundur të bashkëngjisë të paktën një imazh të vendimeve IDT që lëshon.

## **6. LËSHIMI I NJË IDT**

Nën këtë pikë do të trajtohen temat e mëposhtme:

- Periudhat e Lëshimit;
- Roli i Laboratorëve;

- Hartimi i një IDT;
- Përshkrimi i mallrave;
- Justifikimi i klasifikimit ;
- Informacion konfidencial;
- “Indeksimi” (të shtosh fjalët kyçe);
- Imazhet;
- Lëshimi final i IDT-së.

### ***6.1 Periudhat e lëshimit të vendimit***

Afatet kohore që lidhen me trajtimin e aplikimeve IDT trajtohen si më poshtë :

Kur administrata doganore bindet se ka në dispozicion të gjitha elementet e nevojshme për të marrë një vendim, duhet të njoftojë pa vonesë aplikuesin dhe gjithashtu ta informojë atë për kohën kur ka filluar periudha e lëshimit. KD parashtron që vendimi duhet të merret sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda 120 ditëve nga pranimi i aplikimit, përveç nëse specifikohet ndryshe. (pika 3, Neni 27 i KD).

Megjithatë, nëse autoriteti doganor nuk mund të lëshojnë vendimin brenda afatit prej 120 ditësh, kërkuesi duhet të njoftohet për këtë fakt para se afati prej 120 ditësh të skadojë, duke treguar periudhën tjetër kohore të cilën ai e konsideron të nevojshme, për të marrë një vendim. Autoriteti doganor në një situatë të tillë ka edhe 30 ditë shtesë për të nxjerrë vendimin, përveç nëse specifikohet ndryshe. (pika 3, Neni 27 i KD)

Në rastet kur kërkohen analiza laboratorike, aplikimi mund të konsiderohet i plotë kur përgjigjet e këtyre analizave janë të disponueshme dhe afati kohor për lëshimin e IDT fillon vetëm që nga ky moment. Prandaj, është e rëndësishme që administrata doganore të përcaktojë sa më shpejt që të jetë e mundur, pas pranimi të aplikimit, nëse kërkohet një kampion për kryerje analize. (pika 1, Neni 29 i DZ)

Nëse, pas pranimi zyrtar të një kërkesë, autoriteti doganor kompetent përcakton se kërkohet informacion shtesë, ai mund t’ia kërkojë atë aplikuesit, të cilit i jepet një periudhë kohore prej jo më shumë se 30 ditësh për të kthyer përgjigje. Afati kohor për marrjen e vendimit do të zgjatet deri në kohën që i jepet aplikuesit për të siguruar informacionin e kërkuar. (pika 1, Neni 21 i DZ)

Administrata doganore informon aplikuesin për çdo faturë të bashkangjitur për kryerjen e një analize të kërkuar. Nëse aplikuesi refuzon të paguajë këto fatura, autoriteti doganor nuk do të lëshojë një vendim IDT me arsyetimin se të gjitha informatat e nevojshme për të marrë një vendim nuk i janë vënë në dispozicion.

## **6.2 Roli i Laboratorëve**

Është përgjegjësi e aplikuesit për të siguruar të gjithë informacionin, por në disa raste, për shkak të natyrës teknike dhe komplekse të përbërjes së mallrave, mund të nevojiten analiza laboratorike për të përcaktuar klasifikimin e një malli të caktuar.

Analizat laboratorike ndihmojnë për të arritur objektivat e mëposhtme:

- Përcaktimin e përbërjes së mallit (kryesisht lidhur me ato produkte klasifikimi tarifor i të cilave varet nga përbërja e saktë e malit (p.sh. produktet bujqësore, produktet kimike, tekstile, këpucë, etj...);
- Konfirmimin e informacionit që vjen nga aplikuesi;
- Përcaktimin e arsytimit të klasifikimit.

Analizat janë veçanërisht të rëndësishme për aplikimet e IDT të mallrave për të cilat klasifikimi tarifor varet nga përbërja e saktë e tyre (p.sh. prodhimet bujqësore, produktet ushqimore, pijet, karburantet, etj.).

Rekomandohet që kur kërkohet një analizë, kampioni/mostra duhet të përcillet në laborator sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të kryhen testet e nevojshme dhe të t'i kthehet përgjigja e rezultatit autoritetit doganor. Ky rekomandim ka për qëllim që të dy palët si laboratorit ashtu dhe struktura vendimmarrëse e IDT-së të kenë kohë të mjaftueshme për të kthyer përgjigje brenda afatit ligjor për nxjerrjen e një vendimi.

Në rastet kur është kryer analiza laboratorike, IDT-ja duhet të pasqyrojë ekzistencën dhe rezultatet e saj. Nëse për shkak të konfidencialitetit rezultati i analizës nuk mund të përfshihet në "përshkrimin e mallrave" në kutinë 7, duhet të tregohet në kutinë 8 "emërtimi tregtar dhe informacione shtesë".

Duhet theksuar që legjislacioni doganor që rregullon IDT-në ngarkon aplikuesin me kostot e analizave laboratorike.

## **6.3 Hartimi i IDT-së**

IDT është një vendim i marrë nga autoriteti doganor kompetent i cili është i detyrueshëm për autoritetin doganor dhe për mbajtësin.

Kur hartohet një IDT, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë pikave të mëposhtme:

- Përshkrimi i mallrave;
- Arsytimi për klasifikimin;
- Konfidencialiteti;
- Indeksimi (shtimi i fjalëve kyce); dhe
- Imazhet.

#### **6.4 Përshkrimi i mallrave**

Vendimet IDT lëshohen vetëm për një lloj malli.

Shembuj të një lloji mallrash do të ishin:

- Vazo lulesh prej balte të pa dekoruara, për përdorim kopshtarie të kreut 6914;
- Thika për tavolinë pavarësisht materialit përbërës të dorezave të tyre të kreut 8211.

Përshkrimi i mallrave të veçanta duhet të:

- jetë mjaftueshëm i detajuar në mënyrë që të lejojë që mallrat të njihen pa asnjë dyshim;
- përfshijë detaje përveç kuotave nga nomenklatura e kombinuar e mallrave që e ka çuar në këtë klasifikim ;

Është e qartë se cilësia e përshkrimit është jetike për të ndihmuar në arritjen e qëllimit të një IDT-je, përkatësisht për të lehtësuar operatorin në lehtësimin e procedurave doganore. Vetëm kur autoriteti doganor është në gjendje të lidhë lehtësisht mallin e përshkruar në IDT me mallin e paraqitur për zhdoganim, atëherë IDT-ja i shërben qëllimit të saj. Kështu, ndikimi ligjor i IDT-së bazohet kryesisht në cilësinë e përshkrimit.

Nëse përshkrimi është i pasaktë ose i paqartë, zbatimi i vendimit IDT mund të vihet në pikëpyetje në momentin e zhdoganimit nëse autoriteti doganor dyshon se mallrat e paraqitura nuk janë të njëjta me ato të përshkruara në vendim.

Nëse përshkrimi i mallrave është i qartë dhe nuk ka dyshim se mallrat e paraqitura në momentin e zhdoganimit i korrespondojnë mallrave të përshkruara në vendimin e IDT-së, atëherë IDT duhet të pranohet pavarësisht nga klasifikimi tarifor i caktuar për mallrat. (shkronja a), pika 4, Neni 36 i KD)

Një vendim i IDT nuk zëvendëson kontrollet doganore, por duhet të lehtësojë dhe përshpejtojë procedurën e zhdoganimit.

Përshkrimi i mallit duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme. Nëse një përshkrim është shumë i detajuar ose shumë i paqartë, ekziston rreziku për probleme kur përdoret.

Shembuj të përshkrimit të paqartë do të ishin terma të thjeshta gjenerike të tilla si "bojë", "arra" ose "makarona". Përderisa nuk ka dyshim se çfarë janë këto produkte, klasifikimi i tyre i saktë tarifor varet nga detajet shitesë në lidhje me përbërjen, paraqitjen, etj Ndërsa një punonjës doganor mund të përcaktojë vizualisht se një lëng është lëng portokalli, ai nuk do të ishte në gjendje të tregonte nëse ka sheqer të shtuar ose cila është për shembull vlera e tij Brix. Është edhe më e rëndësishme që mallrat e klasifikuara në krerët e mbetur ("të tjera") të përshkruhen me kujdes.

Një shembull i një përshkrimi të pa qartë është:

“Ky çelës me pozicionin pozitiv të hapjes dhe mbylljes me veprim të pavarur ndërrimi, hapësire dyfishe, me elemente kontakti të lidhur nëpërmjet një kavo të mbi stampuar në lidhje. Kapaciteti i ndërrimit nominal 6A 250 V. Frekuenca e funksionimit CA 3600 operacione në orë ”.

Nga ky përshkrim nuk është aspak e qartë se me çfarë malli kemi të bëjmë dhe për çfarë do të përdoret. Megjithatë ka shumë informacione, nuk shpjegohen detajet kryesore në një mënyrë logjike ose të strukturuar.

Përshkrimet e paqarta mund të çojnë në një situatë që operatori ekonomik nuk është në gjendje të përdorë IDT-në kur deklaron mallrat në doganë.

Për të siguruar përshkrimin më të mirë të mundshëm të mallrave në vendimet IDT duhet t'i përgjigjemi 5 pyetjeve kryesore

- a) **Cilat janë mallrat?** (Emërtimi i mallrave) *Një xhup me kapuç për burra.*
- b) **Si duken mallrat?** (Përshkrimi fizik i mallrave) *Ka një hapje të plotë përpara me zinxhir. Mbërthehet me perçina nga e majta në të djathtë. Ka një jakë që ka një kapuç të fshehur dhe mëngë të gjata me mansheta. Ai është i mbushur me pupla.*
- c) **Për çfarë dhe si përdoren mallrat?** (Funksioni) *Për të mbuluar pjesën e sipërme të trupit nga shpatullat deri tek mesi.*
- d) **Nga çfarë përbëhen mallrat?** (Përbërja) *Është e përbërë nga pëlhurë e thurur që konsiderohet e mbuluar me sy të lirë 100% najlon.*
- e) **Ndonjë veçori dalluese?** *Togëz me rrip prej llastiku që lidhet në mes.*

Përshkrimi i plotë do të ishte:

"Një xhup me kapuç për burra me hapje të plotë përpara dhe me zinxhir që mbërthehet me perçina nga e majta në të djathtë. Ka një jakë me kapuç të fshehur dhe me mëngë të gjata me mansheta. Është i mbushur me pupla. Mbulon pjesën e sipërme të trupit nga shpatullat deri tek mesi. Është i përbërë nga pëlhurë e thurur që konsiderohet, me sy të lirë 100% najlon. Ka dhe një togëz me rrip prej llastiku që lidhet në mes"

Përveç përshkrimit fizik të mallrave, duhet të merret parasysh edhe paketimi dhe nëse ato paraqiten për t'u klasifikuar si një grup. Për shembull, mallrat mund të paketohen për shitje me pakicë me sende të tjera, duke treguar se paketat individuale shiten si një grup. Megjithatë, autoriteti doganor mund të vendosë që artikujt e ndryshëm nuk përbëjnë një komplet për qëllime doganore dhe secili element më pas klasifikohet ndaras dhe rrjedhimisht vendimi IDT lëshohet për secilin mall.

Në këto kushte është e rëndësishme që çdo vendim i IDT-së të lidhet me artikujt e tjerë në paketim. Referenca në vendimet e tjera të IDT duhet të përfshihet në përshkrimin e mallrave.

Përveç një përshkrimi të hollësishëm, lidhja e një imazhi do të rrishte efikasitetin e një përshkrimi të strukturuar.

### ***6.5 Arsyetimi për klasifikimin***

Të gjitha vendimet IDT duhet të jenë në përputhje me legjislacionin doganor të RSH-së. Kur të lëshohet një vendim IDT duhet të sqarohet qartë në Kutinë 9 të aneksit përkatës se si është arritur vendimi i klasifikimit. Arsyetimi duhet të strukturohet në mënyrë logjike dhe të qartë që të lejojë mbajtësin e vendimit dhe autoritetin doganor të kuptojnë qartë arsyet si për refuzimin e krerëve të veçantë ashtu edhe për kreun e klasifikuar në vendim.

Një arsyetim i formuluar në mënyrë të saktë duhet të jetë i plotë dhe të mos përmbajë shkurtime të pashpjegueshme. Duhet të strukturohet në renditjen si më poshtë:

- Rregullat e Përgjithshme për Interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar ;
- Shënimet e Seksionit dhe Kapitullit dhe shënimet e nën paragrafëve;
- Shënimet shtesë;
- Rregulloret e Klasifikimit;
- Sistemin e Harmonizuar dhe Shënimet Shpjeguese të Nomenklaturës së Kombinuar;
- Vendimet dhe opinionet e Klasifikimit të Sistemit të Harmonizuar;
- Opinionet e Klasifikimit BE;
- Vendimet e Gjykatave.

Është e rëndësishme që arsyet për përfshirjen dhe përjashtimin e mallrave nga krerë të veçantë tariforë të jenë të qarta. Një informacion i tillë nxit transparencën dhe ndihmon operatorët ekonomik të kuptojnë se pse mallrat e tyre klasifikohen në një kre të caktuar.

### ***6.6 Konfidencialiteti***

Një aspekt i rëndësishëm i IDT është konfidencialiteti. Nenet 20 dhe 21 të KD vendosin një detyrim ligjor për të trajtuar informacionin e fituar nga autoritetet doganore ose shkëmbyer me operatorët ekonomik si konfidenciale.

Çështja e konfidencialitetit përfshin dy zëra:

- Informacionin e paraqitur nga aplikuesi;
- Informacionin e dhënë nga Administrata Doganore
- Informacioni i mëposhtëm i paraqitur nga aplikuesi do të konsiderohet gjithmonë konfidencial;
- Detajet në lidhje me mbajtësin (emër etj.);

- Emërtimi tregtar;
- Informacioni shtesë (p.sh përbërja e produkteve kimike, analizat laboratorike);
- Logot të mostrave.

Shënimi i rëndësishëm pas kutisë 3 në formularin e aplikimit IDT informon aplikuesin se kur ai / ajo nënshkruan formularin e aplikimit IDT pranon gjithashtu që çdo informacion i ofruar mund të ruhet në një bazë të dhënash elektronike të menaxhuar nga Autoriteti Doganor dhe mund të bëhet publik me përjashtim të informacionit në lidhje me mbajtësin (kutia 2), emërtimit tregtar dhe informacionit shtesë (kutia 9).

Administrata doganore është e detyruar gjithashtu të përdorë diskrecionin e saj kur bashkëngjiten imazhe. Edhe nëse aplikuesi nuk arrin të përcaktojë informacionin që dëshiron të trajtohet si konfidencial, informacioni i mëposhtëm duhet të trajtohet gjithmonë si konfidencial:

- Marka Tregtare;
- Referencat e Produktit;
- Rezultatet e analizave laboratorike ;
- Kontejnerët apo karakteristika të tjera, në rastet kur karakteristikat janë sinonime (të njëjta me një produkt).

Imazhet e mallrave me një etiketë ose me karakteristika të tjera dalluese (p.sh. forma e enëve) duhet të trajtohen si konfidenciale nga administrata doganore pa përjashtim.

Është gjithashtu e mundur të bashkëngjiten imazhe në të dyja fushat si atë publike edhe konfidenciale, nëse autoriteti doganor beson që kjo do të ishte e dobishme për përfituesin.

### **6.7 “Indeksimi” (shtimi i fjalëve kyçe)**

Një sistem kërkimi i përshtatshëm në bazën e të dhënave të IDT-ve bazohet në shfrytëzimin e fjalëve kyçe, pra shtimin e fjalëve.

Duke pasur parasysh natyrën subjektive të indeksimit, kërkohet një shkallë standardizimi për të siguruar që e njëjta strukturë të ndiqet pavarësisht llojit të produktit. Metodologjia e përgjithshme e indeksimit duhet të ndjekë të njëjtën strukturë si përshkrimi dhe përkatësisht si vijon:

- Fjalë kyçe që përcaktojnë llojin e produktit;
- Fjalë kyçe që përcaktojnë gjendjen fizike të produktit;
- Fjalë kyçe që përcaktojnë funksionin apo përdorimet e produktit;
- Fjalë kyçe që përcaktojnë secilin nga elementët përbërës të produktit;
- Fjalë kyçe që përcaktojnë paketimin në rastet kur është e nevojshme;
- Fjalë kyçe që përcaktojnë faktorët mbi të cilët bazohet klasifikimi;

Përveç strukturës, duhet të respektohen disa rregulla të përgjithshme mbi indeksimin:

Indeksi duhet të fillojë domosdoshmërisht me një përshkrim konkret, pra me një emër si "pallto", "kufje", "nyje metali", "krap";

- Struktura e indeksimit duhet të jetë e njëjtë me atë të përshkrimit;
- Indeksi duhet të jetë reflektim i përshkrimit dhe i asgjëje tjetër; veçanërisht jo ai i klasifikimit tarifor, pra indeksi duhet të përfshijë një informacion që shfaqet në përshkrim.
- Të dhënat konfidenciale nuk mund të përmenden as në përshkrim dhe as në indeksim;

### **6.8 Imazhet**

Përshkrimi i qartë dhe i saktë është elementi më i rëndësishëm në një vendim IDT pas klasifikimit tarifor, përshkrimi mund të përmirësohet më tej duke shtuar një imazh të mallrave në fjalë. Imazhet mund të sqarojnë menjëherë natyrën dhe karakteristikat e mallrave dhe ta bëjnë shumë më të lehtë për autoritetet doganore procedurën e hedhjes në qarkullim të mallrave .

Disa produkte janë shumë të qarta dhe imazhet e tyre nuk shtojnë ndonjë gjë. Kjo është e vërtetë veçanërisht për pluhurat dhe lëngjet. Megjithatë, produkte të tjera kanë karakteristika mjaft të dallueshme apo të veçanta për të merituar një imazh bashkëngjitur IDT.

Në përgjithësi, imazhet duhet t'i referohen mostrave të paraqitura nga aplikuesi. Megjithatë, ekstrakte përkatëse nga broshurat ose prodhuesit e literaturës, tabelat e të dhënave dhe, aty ku është e përshtatshme, formulat dhe përmbajtjet e paraqitura në paketim mund të bashkëngjiten si imazhe.

Konfidencialiteti duhet të merret gjithmonë në konsideratë kur i bashkëngjiten imazhe vendimeve të IDT-së. Rekomandohet që imazhi të bëhet konfidencial në IDT duke errësuar emrat apo logot tregtare, si dhe ku paketimi i produktit është i dallueshëm një markë të caktuar. Është gjithashtu e mundur të bashkëngjiten imazhe që janë konfidenciale së bashku me të tjerët që nuk janë konfidenciale. Gjëja e rëndësishme është që çdo imazh i bashkëngjitur në një vendim IDT të vendoset në kategorinë e duhur dhe të plotësojë kuptimin e produktit që përshkruhet.

Në mënyrë ideale, një imazh duhet t'i bashkëngjitet aplikimit dhe vendimit që rezulton me IDT. Kjo krijon automatikisht një lidhje midis të dy dokumenteve. Megjithatë, nëse nuk paraqitet as një imazh as një mostër me aplikimin, administrata mund shtojë një imazh në aplikacion në një datë të mëvonshme.

Rekomandohet që të paktën një imazh i bashkëngjitur aplikimit të bartet në vendimin përfundimtar IDT, duke krijuar kështu një lidhje vizuale midis dy dokumenteve. Duke pasur parasysh se shumë kërkime fillestare në bazën të dhënave janë kryer në bazë të imazheve, një lidhje e tillë mund të jetë e rëndësishme për punonjësin që bën kërkimin.



Për më tepër, gjithashtu rekomandohet që imazhet e bashkangjitura në vendimet e IDT-së të jenë unike aq sa është e mundur. Nëse imazhi rrjedh nga broshurat e prodhuesit, mund të mos jetë gjithmonë e mundur të jetë një imazh unik (siç janë p.sh. automjetet).

Informacioni i imazhit mund të shfaqet në forma të ndryshme:

- Foto dixhitale;
- Tekste dhe ilustrime të skanuara (p.sh. përshkrime të produktit, lista e përbërësve, vizatime, diagrame ndërtimi), si dhe
- Dokumente të ndryshme (p.sh broshura të printuara).

Imazhet e bashkangjitura në aplikimet e IDT dhe vendimet IDT duhet gjithmonë të jenë të rëndësishme për mallrat. Kujdes duhet të ushtrohet për të siguruar që imazhet të jenë të vendosura në vendimin IDT-së; nëse identifikimi i shenjave, logos, etj., nuk mund të errësohet duhet të vendoset në fushën konfidenciale. Gjithashtu është e mundur të bashkëngjitet një imazh publik dhe konfidencial të të njëjtit produkt në të njëjtën IDT nëse konsiderohet e dobishme për autoritetin doganor. Duke pasur parasysh se aplikimet e IDT nuk janë të njohura për publikun, nuk ka asnjë arsye për të përjashtuar imazhet në aplikime që.

Numri i imazheve të bashkangjitura në një aplikim të IDT ose një vendimi është çështje që e vendos autoriteti doganor që e lëshon. Për disa mallra një imazh i vetëm mjafton, ndërsa mallrat e tjera mund të kenë karakteristika unike ose të veçanta etj., për të cilat nevojiten disa imazhe.

Gjatë përgatitjes së imazheve duhet të merren parasysh pikat e mëposhtme:

- Fotografoni imazhin e objektit kundrejt sfondit neutral. Shmangni sfondet e zbukuruar pasi ato rrisin madhësinë e imazhit. Për më tepër, sfondet neutrale janë më pak të vëmendshme, sidomos kur objekti në imazh është zbukuruar gjithashtu.
- Rezolucioni i imazhit nuk duhet të rritet nëse nuk është e nevojshme për prodhimin e një imazhi të qartë. Në vend të kësaj, shqyrtoni marrjen e një pamjeje të përgjithshme të objektit dhe plotësoni atë me imazhe të afërta me detaje të rëndësishme, të gjitha me rezolucion më të ulët. Një zgjidhje e tillë është më e mirë se një imazh me rezolucion të lartë.
- Konsideroni mënyrën më të mirë për të përcjellë karakteristikat e rëndësishme të objektit që po paraqitet. Aspekte të tilla si ton ngjyra, cilësi dhe dritë dhe hije mund të jenë të rëndësishme për të përcjellë kuptimin në imazh.
- Duhet t'i kushtohet vëmendje mënyrës se si të transmetohet më mirë natyra dhe karakteristikat e rëndësishme të objektit. Për shembull, madhësia e një objekti mund të jetë e rëndësishme, por duhet të merret në konsideratë mënyra më e mirë për ta përcjellë atë në një imazh. Ndërsa një detaj i tillë mund të mos ketë rëndësi për klasifikimin, mund të jetë e rëndësishme për qëllime identifikimi kur zhdoganon mallrat në doganë.

- Nuk ka kufi për numrin e imazheve që mund t'i bashkëngjiten një aplikacioni ose një vendimi IDT. Arsyetimi për bashkëngjitjen e ndonjë imazhi në një aplikim ose vendimi IDT është se ai përcjell informacion të rëndësishëm dhe siguron një kuptim më të mirë të objektit.

### **6.9 Lëshimi i vendimit IDT**

Kur Administrata Doganore arrin në përfundimin që kërkesa është e plotë dhe e saktë dhe se nuk ka vendime të ndryshme të IDT për klasifikimin që deklaron, duhet të lëshojë vendimin e IDT dhe ta bëjë atë të disponueshëm për konsultim.

Duhet të theksohet se sapo të publikohet një IDT në bazën e të dhënave, mund të ndryshohet vetëm në tre aspekte: datën e përfundimit të vlefshmërisë, kodin që tregon pse ka pushuar të jetë i vlefshëm dhe një "periudhë të zgjatur përdorimi".

## **7. VENDIMET JO UNIFORME TE IDT**

Arsyeja kryesore për dhënien e informacionit të detyrueshme tarifor është sigurimi i aplikimit uniform të legjislacionit doganor. Autoritetet doganore duhet të shmangin lëshimin e vendimeve të ndryshme IDT.

Vendimet IDT jo uniforme ndodhin, për çfarëdo arsye, kur dy ose më shumë vendime IDT për produkte identike ose shumë të ngjashme e klasifikojnë atë me kod të ndryshëm tariforë. Një situatë e tillë krijon një çekuilibër në trajtimin e operatorëve ekonomik.

Duke ndjekur këtë Udhëzim duhet të minimizohet numri i vendimeve të ndryshme IDT. Megjithatë, është e rëndësishme të trajtohet pyetja se si të duhet të trajtohet IDT kur verifikohet se është në kundërshtim me IDT e tjera.

## **8. NATYRA LIGJORE E NJË IDT**

Mbështetur në Ligjin 102/2014 “Kodi Doganor i RSH” periudha e vlefshmërisë së një IDT është 3 vjet (pika 3, Neni 36 i KD).

Vendimet e IDT nuk mund të hyjnë në fuqi, ose të lëshohen me fuqi prapavepruese. Vendimet IDT do të jenë të detyrueshme për autoritetet doganore dhe mbajtësin, vetëm në lidhje me mallrat për të cilat janë kryer formalitetet doganore, pas datës në të cilën ajo hyn në fuqi. Në mënyrë të ngjashme, vendime të tilla do të jenë të detyrueshme vetëm për mbajtësin dhe autoritetet doganore, vetëm me efekt nga data në të cilën mbajtësi ka pranuar ose është konsideruar se ka marrë njoftimin për vendimin (shkronjat (a) dhe (b), pika 2, Neni 36 i KD).

Për operatorët ekonomik ekziston detyrimi ligjor që të deklarojnë vendimet e tyre të IDT-së dhe t'i përdorin ato kur importojnë ose eksportojnë mallrat në fjalë. (shkronja b, pika 2, Neni 36 i KD)

Për më tepër, përgjegjësia për deklarimit e saktë të mallrave në doganë bie mbi operatorin ekonomik që po importon ose eksporton mallrat. Operatorët ekonomik që emërojnë përfaqësues duhet të sigurojnë që ata përfaqësues të jenë plotësisht të vetëdijshëm për çdo vendim të IDT që ata mbajnë.

Autoritetet doganore do të monitorojnë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ai vendim, duke përfshirë detyrimin për mbajtësin për të deklaruar dhe përdorur IDT pika 5, Neni 28(KD)

## **9. E DREJTA DUHET PER T'U DEGJUAR**

E drejta për t'u dëgjuar vlen për situatat kur autoritetet doganore do të marrin një vendim që do të ndikonte negativisht për aplikuesin.

Autoritetet doganore kanë detyrimin t'i komunikojnë aplikuesit arsyet në të cilat bazohet vendimi i tyre. Atij i duhet dhënë mundësia që të shprehë mendimin e tij (neni 22 (6) KD). Periudha e kohës që aplikuesi duhet të shprehë mendimin është 30 ditë nga data në të cilën ai ka marrë njoftim.

Këshillohet që personi i interesuar (aplikuesi/mbajtësi i vendimit) të informojë autoritetin doganor nëse dëshiron të heqë dorë nga e drejta e tij për t'u dëgjuar. Vendimi ITD i personit i cili vendos të heqë dorë nga e drejta e tij për t'u dëgjuar duhet të revokohet.

Neni 14 dhe 16 i DZ autorizon autoritetet doganore të marrin vendimin kur personi i interesuar shpreh këndvështrimin e tij para skadimit të periudhës 30-ditore, përveç nëse ai njëkohësisht shpreh më tej këndvështrimin e tij brenda kësaj periudhe.

Në rastet kur personi në fjalë nuk përgjigjet brenda periudhës 30-ditore, ITD e këtij vendimi duhet të revokohet.

Në rastet kur personi në fjalë vendos të përdori të drejtën e tij për t'u dëgjuar dhe argumentet e tij janë të pabazuara, vendimi i cili ndikon negativisht tek kërkuesi duhet të mirë përcaktojë arsyet në të cilat bazohet ky vendim (Pika 7 e Nenit 27 të KD).

### **9.1. Rastet ku vlen e drejta për t'u dëgjuar:**

- 1. Autoriteti Doganor vendos të mos nxjerrë një vendim të IDT*

E drejta për t'u dëgjuar duhet të lejohet kur autoriteti doganor refuzon të nxjerrë një vendim IDT. Meqenëse refuzimi i lëshimit të një IDT mund të shkaktoj dëm për interesat ekonomike të operatorit ekonomik, autoriteti doganor duhet ta njoftojë aplikuesin për vendimin që do të marri, në mënyrë që ai të shprehë këndvështrimin e tij për këtë çështje.

## 2. *Anulimi i një vendimi të IDT*

Nëse një IDT është lëshuar bazuar në informacion jo të saktë ose të paplotë nga aplikuesi Autoritetet doganore duhet të informojnë aplikuesin për anulimin e kësaj IDT duke i dhënë atij më parë të drejtën për t'u dëgjuar.

## **10. ANULLIMI I VENDIMEVE IDT**

Autoritetet doganore që kanë nxjerrë një vendim në çdo kohë mund ta anulojnë atë nëse nuk është në përputhje me legjislacionin doganor (pika 3, Neni 28 i KD). Kushtet në të cilat një vendim i favorshëm, përveç një vendimi IDT, mund të anulohet janë të përcaktuara në pikën 1, Neni. 31 KD. Megjithatë, në kontekstin e vendimeve të IDT, kriteri i vetëm i zbatueshëm për anulim është që ato të jenë bazuar në informata të pasakta ose jo të plota nga aplikuesit. ( pika 4, Neni 37, KD).

Anulimi i një vendimi IDT hyn në fuqi që nga data në të cilën ka hyrë në fuqi vendimi fillestar. ( pika 3, Neni 31 KD). Mbajtësi i IDT-së duhet të njoftohet në lidhje me anulimin e këtij vendimi. (pika 2, Neni 31 KD).

Në rastin e anulimeve, nuk është e mundur shtyrja e afatit të datës së anulimit. Periudha e përdorimit të zgjatur nuk mund të jepet për një vendim të anuluar, nëse vendimi është marrë në bazë të informatave të pasakta ose jo të plota.

## **11. VENDIMET IDT QË NUK JANË MË TË VLEFSHME APO REVOKOHEN (EX NUNC)**

Periudha ligjore e vlefshmërisë së një vendimi të IDT është 3 vjet. Megjithatë, në rrethana të caktuara, periudha 3 vjeçare mund të shkurtohet dhe IDT do të pushojë së qeni e vlefshme ose të revokohet para se të përfundojë periudha e përcaktuar. (pika 3, Neni 36 KD)

Një vendim IDT pushon së qeni i vlefshëm kur nuk është më në përputhje me legjislacionin doganor si rezultat i ndryshimit të ndonjë prej nomenklaturave të referuara në shkronjat (a) dhe (b), pika 2, të Nenit 56 te KD dhe shkronjat (a) dhe (b) , pika 1, të Nenit 37 të KD.

Autoritetet doganore revokojnë vendimet IDT në rrethanat e mëposhtme:

Në rastet kur nuk është më në përputhje me interpretimin e ndonjë prej nomenklaturave të referuara në shkronjat (a) dhe (b), pika 2, të Nenit 56 dhe shkronjën (a) , pika 1, të Nenit 37 të KD që rezulton nga:

- Ndryshimet në Shënimet Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar të Përshkrimit dhe Sistemit të Kodimit të Mallrave ose Shënimet Shpjeguese të Nomenklaturës së Kombinuar;
- Vendimet e Klasifikimit dhe Opinionet e Organizatës Botërore të Doganave;
- Pas një rishikimi administrativ ku administrata vendos se është bërë një gabim në klasifikim; (pika 3, e Nenit 28 dhe pika 5, e Nenit 37) ;
- Në rastet e gabimit administrativ (p.sh. gabime që nuk ndikojnë në klasifikimin e mallrave siç janë gabimet në emrin ose adresën e mbajtësit ose gabimet ose lëshimet në përshkrimin e mallrave etj.);
- Kur një ose më shumë nga kushtet për marrjen e vendimit nuk ishin apo nuk janë plotësuar. (Neni 28 dhe pika 5, e Nenit 37 të KD).

Duhet të theksohet se vendimet e IDT nuk mund të revokohen me kërkesën e mbajtësit. (pika 5, e Nenit 37 të KD )

Pavarësisht nga rrethanat në të cilat një vendim është revokuar mbajtësi i IDT-së duhet të njoftohet në lidhje me revokimin e këtij vendimi. (pika 3, e Nenit 32 të KD)

Revokimi duhet të vendoset në bazën e të dhënave IDT së bashku me datën në të cilën ky vendim pushon së qeni i vlefshëm.

Vendimet IDT nuk pushojnë të jenë të vlefshme ose të revokohen me efekt prapaveprues. (pika 4, e Nenit 28 dhe pika 3, e Nenit 37 të KD)

Në raste të caktuara, mbajtësi i një vendimi IDT që ka pushuar të qeni i vlefshëm ose i revokuar mund të përfitojë nga periudha e përdorimit të zgjatur në kushte të caktuara. (Shih seksioni 11)

## **12. PERIUDHA E PËRDORIMIT TË ZGJATUR**

Kur një vendim IDT revokohet ose shfuqizohet, mbajtësi i atij vendimi mund të ketë të drejtë të kërkojë një periudhë përdorimi të zgjatur. Zgjatja e kësaj periudhe ka për qëllim të evitojë që operatorët të penalzohen nga rrethanat që nuk varen prej tyre. Megjithatë, periudha e përdorimit të zgjatur mund të jepet vetëm në kushte të caktuara dhe në situata të veçanta.

Periudha e përdorimit të zgjatur nuk jepet për Vendimet e IDT-së që:

- janë anuluar për shkak të informacioneve të pasakta dhe të paplota të paraqitura nga aplikuesi;

- pushojnë së qeni të vlefshëm si rezultat i ndryshimeve në Nomenklaturën e Sistemit të Harmonizuar dhe Nomenklaturës së Kombinuar;
- revokohen për shkak se një ose më shumë nga kushtet për marrjen e vendimit nuk ishin ose nuk janë më të vlefshme;
- revokohen për shkak të gabimeve administrative. Meqë klasifikimi në vendime të tilla nuk ndikohet nga gabimi, nuk ka arsye për të dhënë një periudhë të përdorimit të zgjatur.

Kushtet që duhet të plotësohen për dhënien e një periudhe përdorimi të zgjatur janë si më poshtë:

- Operatori ekonomik në fakt ka të drejtë të kërkojë një periudhë përdorimi të zgjatur;
- Në zbatim të kontratave detyruese të bazuara në atë vendim dhe që janë nënshkruar përpara pushimit të të qenit i vlefshëm apo revokimit të vendimit (pika 9, e Nenit 37 të KD);
- Periudha e përdorimit të zgjatur është kërkuar brenda 30 ditëve nga shpallja e pavlefshme e vendimit (pika 9, e Nenit 37 të KD);
- Arsyeja që ka çuar në shfuqizimin e vendimit IDT nuk përjashton dhënien e periudhës së përdorimit të zgjatur që jepet (pika 9, e Nenit 37).

Kërkesa për periudhë përdorimi të zgjatur duhet t'i dorëzohet autoritetit doganor brenda 30 ditëve nga data në të cilën vendimi i IDT pushon të jetë i vlefshëm ose i revokuar. Operatori ekonomik duhet gjithashtu të japë detaje në lidhje me sasinë për të cilat kërkohet përdorimi i zgjatur dhe të tregojë se cilat nga mallrat do të hidhen për qarkullim të lirë gjatë periudhës së përdorimit të zgjatur (pika 9, e Nenit 37 të KD).

Autoriteti Doganor merr vendim për dhënien ose jo të periudhës së kërkuar të përdorimit të zgjatur dhe njofton mbajtësin sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën ka patur të gjitha informacionet e nevojshme për marrjen e vendimit. Periudha e përdorimit të zgjatur nuk duhet të kalojë 6 muaj, por mund të kufizohet në një periudhë më të shkurtër nëse përcaktohet ndryshe. (pika 9, e Nenit 37 të KD)

Në rastet kur autoriteti doganor vendos të japë një periudhë të përdorimit të zgjatur, ati specifikon datën në të cilën skadon vendimi për përdorim të zgjatur dhe gjithashtu duhet të specifikojë sasinë e mallrave që mund të hidhen në qarkullim të lirë gjatë kësaj periudhe. (Neni 40 DZ) Në rast se kontrata nuk përfshin sasi të veçanta, autoriteti doganor duhet të përcaktojë sasinë e mallrave që mund të hidhen në qarkullim të lirë gjatë periudhës së përdorimit të zgjatur mbi bazën e një parashikimi të arsyeshëm nga mbajtësi.

Gjatë hedhjes në qarkullim të lirë të mallrave me periudhës së përdorimit të zgjatur, mbajtësi duhet të përdorë klasifikimin tarifor të përmendur në IDT e cila pushon së qeni e vlefshme ose revokohet.

Autoriteti doganor që ka vendosur të japë një periudhë të përdorimit të zgjatur do të monitorojnë mbajtësit për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ai vendim. Kjo nënkupton veçanërisht monitorimin e sasisë së mallrave që janë hedhur në qarkullim të lirë gjatë kësaj periudhe. (pika 5, e Nenit 28 të KD).

Periudha e përdorimit të zgjatur nuk mund të përdoret përtej datës së skadimit ose importimit të sasisë së mallrave të përcaktuara. (pika 2, e Nenit 40 DZ).

### **13. LISTË KONTROLLI**

Si ndihmë për nëpunësit në administratën doganore që merren me hartimin dhe lëshimin e vendimeve të IDT-së, ky seksion i fundit i Udhëzimit paraqet një listë të përgjithshme të kontrollit që përshkruan hapat kryesorë që duhen ndërmarrë gjatë lëshimit të IDT-së:

1. Kontrolli i aplikimit për t'u siguruar që janë plotësuar të gjitha kutitë e detyrueshme;
2. Regjistrimi i aplikimit të IDT, mundësisht me një imazh bashkangjitur;
3. Verifikimi nëse ekzistojnë aplikime për të njëjtat mallra dhe për të njëjtë mbajtës.
4. Kontrolli në mënyrë të detajuar i kërkesës për të vlerësuar nëse informacionit i dërguar është i plotë
5. Nëse nevojitet informacion shtesë, të kërkohet nga aplikuesi;
6. Sapo të merren të gjitha informacionet e nevojshme, njoftimi i aplikuesit për fillimin e periudhës prej 120 ditësh;
7. Kontrolli nëse mbajtësi ka të tjera IDT për mallra identike, për të shmangur lëshimin e vendimeve jo uniforme IDT;
8. Detajimi i përshkrimit të mallrave;
9. Paraqitja e motivit të klasifikimit siç këshillohet në dokument;
10. Vendosja e imazheve në IDT duke pasur parasysh rregullat e konfidencialitetit;
11. Lajmërimi i aplikuesit kur vendimi është lëshuar.

#### **14. ZBATIMI I MANUALIT UDHËZUES**

Ngarkohen strukturat doganore, agjencitë doganore dhe operatorët ekonomik të interesuar për zbatimin me korrektësi të këtij manuali.



## **Aneksi 1**

Ndryshimet kryesore në procesin IDT që rrjedhin nga KD

### **1. Faza e aplikimit**

- Personi i paraqitur në formularin e aplikimit IDT si aplikues, do të bëhet automatikisht mbajtësi i vendimit IDT të lëshuar.
- Personi i emëruar si përfaqësues duhet të veprojë në emër të aplikuesit vetëm për aq sa i përket aplikimit.
- Operatorët ekonomik duhet të vendosin numrin e NIPT-it/NUIS-it.
- Operatorët ekonomik, të vendosur jashtë territorit të RSH, mund të aplikojnë dhe t'u lëshohet një vendim IDT, me kusht që ata të kenë një numër NIPT-i/NUIS-it.
- Administrata doganore duhet të publikojnë aplikimin.
- Administrata doganore ka një maksimum prej 30 ditësh nga data e pranimin për të njoftuar aplikuesin për pranimin formal të aplikimit.
- Mos njoftimi i aplikuesit brenda 30 ditëve nga marrja e aplikimit do të thotë që aplikimi pranohet automatikisht.
- Informacionet shtesë të kërkuara nga aplikuesi duhet të dorëzohen brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës. Mos plotësimi me informacion shtesë bën që kërkesa të mos pranohet.
- Aplikuesi nuk ka të drejtë të dëgjohet para se të lëshohet vendimi IDT.
- Aplikuesi ka të drejtë të dëgjohet nëse autoriteti doganor vendos të mos lëshojë një vendim IDT, të anulojë ose tërheqë vendimin IDT ose të mos japë një periudhë të zgjatur përdorimi.

### **2. Faza e lëshimit**

- Vendimet IDT nuk lëshohen për kodet SH.
- Administrata duhet të nxjerrë një vendim IDT brenda 120 ditëve pas pranimin formal të aplikimit.
- Aplikuesi duhet të informohet kur të fillojë afati 120 ditor.
- Gjatë periudhës 120 ditore mund të kërkohen informacione shtesë nga aplikuesi.
- Periudha prej 120 ditësh pezullohet për kohën që i duhet aplikuesit për të dhënë informacionin shtesë dhe do të rifillojë pas pranimin të tij.

- Administrata doganore është e detyruar të bëjë kërkime në bazën e të dhënave IDT dhe të regjistrojnë rezultatet e këtyre kërkimeve.
- Nëse administrata nuk është në gjendje të lëshojë vendimin IDT brenda 120 ditëve, ajo ka 30 ditë kohë shtesë për të nxjerrë vendimin e saj.
- Periudha e vlefshmërisë së vendimeve të IDT është 3 vjet.

### **3. Kur vendimet e IDT janë anuluar**

- Ekziston një kusht i vetëm për anulimin e vendimit të IDT. Një vendim i IDT do të anulohet kur bazohet në informata të pasakta ose jo të plota nga aplikuesi.

### **4. Periudha e përdorimit të zgjatur**

- periudha e përdorimit të zgjatur mund të jepet vetëm për një sasi të caktuar të mallrave.